



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/23  
Datë: 08.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**për përdorimin e telefonave (fiks dhe mobil) në Qeverinë e Republikës së Kosovës**

1. Me qëllim të racionalizimit të shpenzimeve të parasë publike për përdorimin e telefonave në Qeverinë e Republikës së Kosovës, shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Kosovës - Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes Nr: 05/3 i datës 22.01.2008, si dhe pezullohen nenet ( 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 ) të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2008 për përdorimin e telefonave (fiks dhe mobil) në Qeverinë e Kosovës - Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, deri në nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ përkatës nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, të drejtë në përdorim të telefonit postpaid kanë:
  - 2.1. Kryeministri - deri në 150 €;
  - 2.2. Zëvendëskryeministrat - deri në 100 €;
  - 2.3. Ministrat - deri në 70€;
  - 2.4. Zëvendësministrat - deri në 50 €;
  - 2.5. Shefi i stafit të Kryeministrit - deri në 50 €;
  - 2.6. Shefi i kabinetit të Kryeministrit - deri në 50 €;
  - 2.7. Sekretari i përgjithshëm i ZKM - së - deri në 50 €.
3. Të drejtë për mbushje të telefonit kanë:
  - 3.1. Shefat e kabineteve të zëvendëskryeministrave dhe ministrave - 30 €;
  - 3.2. Këshilltarët politikë të Kryeministrit - 30 €;
  - 3.3. Këshilltarët politikë të zëvendëskryeministrave - 30 €;
  - 3.4. Këshilltarët politikë të ministrave - 30 €;

- 3.5. Këshilltarët politikë të zëvendësministrave - 30 €;
  - 3.6. Nëpunësit e punësuar në Kabinetin e Kryeministrit - 20 €;
  - 3.7. Nëpunësit e punësuar në Kabinetin e zëvendëskryeministrave, ministrave dhe zëvendësministrave -20 €;
  - 3.8. Sekretarëve të përgjithshëm të ministrave - 30 €;
  - 3.9. Drejtorët ekzekutiv të agjencive - 30 €;
  - 3.10. Drejtorët e zyrave të ZKM-së - 20 €;
  - 3.11. Drejtorët e departamenteve si dhe pozitat e barasvlershme - 20 €;
  - 3.12. Udhëheqësit e divizioneve si dhe pozitat e barasvlershme - 20 €;
  - 3.13. Nëpunësit e punësuar në Zyrën e Sekretarit të përgjithshëm të ZKM-së - 20 €.
4. Të drejtë për përdorim të telefonit fiks kanë të gjithë zyrtarët e përcaktuar në pikën 2 dhe 3 të këtij Vendimi, si dhe nëpunësit tjerë civil të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- 4.1. Kryeministri - deri në 100 €;
  - 4.2. Zëvendëskryeministrat - deri në 80 €;
  - 4.3. Ministrat - deri në 70 €;
  - 4.4. Zëvendësministrat - deri në 50 €;
  - 4.5. Shefi i stafit të Kryeministrit - deri në 50 €;
  - 4.6. Shefat e kabinetit të Kryeministrit, zëvendëskryeministrave dhe ministrave - deri në 40 €;
  - 4.7. Këshilltarët politikë të Kryeministrit - deri në 30 €;
  - 4.8. Këshilltarët politikë të zëvendëskryeministrave - deri në 30 €;
  - 4.9. Këshilltarët politikë të ministrave - deri në 30 €;
  - 4.10. Këshilltarët politikë të zëvendësministrave - deri në 30 €;
  - 4.11. Nëpunësit e punësuar në Kabinetin e Kryeministrit - deri në 20 €;
  - 4.12. Nëpunësit e punësuar në Kabinetin e zëvendëskryeministrave, ministrave dhe zëvendësministrave - deri në 20€;
  - 4.13. Sekretari i përgjithshëm i ZKM - së deri në 30 €;
  - 4.14. Sekretarët e përgjithshëm të ministrave - deri në 30 €;
  - 4.15. Drejtorët ekzekutiv të agjencive - deri në 30 €;
  - 4.16. Drejtorët e zyrave të ZKM-së - deri në 30 €;
  - 4.17. Drejtorët e departamenteve si dhe pozitat e barasvlershme - deri në 20 €;
  - 4.18. Udhëheqësit e divizioneve si dhe pozitat e barasvlershme - deri në 15 €;
  - 4.19. Të gjithë nëpunësit tjerë civil - deri në 10 €.
5. Të drejtë për pajisje me SIM kartelë kanë: Kryeministri, zëvendëskryeministrat, ministrat, zëvendësministrat, Shefi i stafit të Kryeministrit, Shefi i kabinetit të Kryeministrit, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i ZKM -së.
6. Me anë të këtij vendimi, autorizohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Transfereve (MFT) dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP), të përgatis dhe t'ia propozojë Qeverisë për miratim Projekt-Udhëzimin Administrativ për përdorimin e telefonave në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

7. Obligohet Zyra e Kryeministrit, ministritë si dhe të gjitha institucionet relevante për zbatimin e këtij vendimi.
8. Vendimi hyn në fuqi nga data 01.05.2020.

**Albin KURTI**



---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/23

Datë: 08.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e fuqizimit të sektorit financiar.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/23  
Datë: 08.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Kërkohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të bëjë ndryshimin dhe tejkalimin e përkohshëm të rregullave fiskale të deficitit si dhe kufizimit të bilancit bankar të përdorshëm, sipas nenit 22B të Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L- 221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, sipas Shtojcës (Tabelës Nr. 1) e bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve që brenda gjashtë (6) muajve nga kalimi i situatës së pandemisë të hartojë një plan afatmesëm brenda të cilit do të përshtat kufirin e tejkalimeve të përkohshme të autorizuara nga Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe t'i sjell ato në përputhje me nenin 22A të Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L- 221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit që të procedojë këtë Vendim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**


Bazuar në situatën e pandemisë si dhe në zbatim të Pakos Fiskale Emergjente të aprovuar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/19 të datës 30.03.2020, disa nga masat e pakos mund të zbatohen nga buxheti aktual përmes alokimeve të parakohshme, ose/dhe me disa rregullime që behën nga Qeveria e Republikës së Kosovës bazuar në autorizimet e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar si dhe Ligjit Nr. 07/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Vitin 2020. Megjithatë, për disa elemente tjera kërkohet rregullime buxhetore, të cilat mund të ndodhin në proces, por kjo nuk e pengon zbatimin e pakos në elemente të caktuara.

Meqë disa nga parametrat makro-fiskal të paraqitur në Tabelën Nr. 1 të Ligjit Nr. 07/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Vitin 2020 ndikohen nga situata e krijuar, nevojitet të ndryshohen përkohësisht disa nga rregullat fiskale të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar. Në pajtim me nenin Neni 22B (Rritja e përkohshme e kufirit të deficitit) këto ndryshime paraqiten për aprovim.

Për qëllim të njoftimit paraprak lidhur me ndryshimin e këtyre parametrave buxhetor dhe makro-fiskale, Tabela Nr. 1 e Ligjit Nr. 07/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Vitin 2020 është përshtatur dhe janë reflektuar projeksionet e reja, të cilat përfshin edhe rregullat fiskale të lartpërmendura. Tabela Nr. 1 e rishikuar dhe Pako Fiskale Emergjente është pjese përbërëse e këtij dokumenti.

Përmes këtij Vendimi nuk ka ndryshime në ndarjet buxhetore sipas tabelave buxhetore. Ministria e Financave dhe Transfereve ka identifikuar burime shtesë të financimit të deficitit, i cili do të financohet nga burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit, përmes letrave me vlerë, kredive ndërkombëtare si dhe granteve.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Tabela 1: Parashikimet fiskale (të Hyrat dhe Shpenzimet)

Përshkrimi	2019	2020 Budget	2020 Rishikim.	2021 Proj.	2022 Proj.
në miliona Euro					
<b>I. GJITHSEJ TË HYRAT BUXHETORE</b>	<b>1,888.6</b>	<b>2,020</b>	<b>1,822</b>	<b>2,128</b>	<b>2,247</b>
<i>nga te cilat: nga ulja e stokut të borxhit tatimor</i>	21.8	27	27	27	27
<i>nga përmirësimi i përmbushjes tatimor</i>	14.0				
<b>1.1 Të Hyra Tatimore</b>	<b>1,662.0</b>	<b>1,783</b>	<b>1,600</b>	<b>1,893</b>	<b>2,003</b>
<b>Tatimet Direkte</b>	<b>292.3</b>	<b>312</b>	<b>258</b>	<b>331</b>	<b>348</b>
<i>Tatimi në të ardhurat e korporatave</i>	94.6	100	79	107	112
<i>Tatimi në të ardhura personale</i>	165.6	176	150	185	195
<i>Tatimi në pronë</i>	27.3	31	26	35	37
<i>Të tjera</i>	4.8	4	4	4	4
<b>Tatimet Indirekte</b>	<b>1,415.3</b>	<b>1,521</b>	<b>1,391</b>	<b>1,617</b>	<b>1,711</b>
<i>Tatimi mbi Vlerën e Shtuar</i>	845.6	939	851	999	1,061
<i>Vendore:</i>	239.2	276	245	290	305
<i>Kufitare:</i>	606.4	662	606	709	755
<i>Detyrimi Doganor</i>	130.3	123	114	140	150
<i>Akcizë</i>	435.5	454	422	474	495
<i>Të tjera</i>	3.8	4	4	5	5
<b>Rimbursimet tatimore</b>	<b>-45.5</b>	<b>-50</b>	<b>-50</b>	<b>-56</b>	<b>-56</b>
<b>1.2 Të Hyrat Jo-Tatimore</b>	<b>216.1</b>	<b>228</b>	<b>209</b>	<b>225</b>	<b>234</b>
<i>Taksa, ngarkesa dhe të tjera - Nivelit Qendror</i>	121.9	126	115	120	127
<i>Taksa, ngarkesa dhe të tjera - Nivelit Lokal</i>	50.0	50	47	50	50
<i>Taksa koncesionare</i>	11.1	13	13	17	20
<i>Renta Minerare</i>	29.4	33	29	33	33
<i>Të hyrat nga Interesi (NP-ve)</i>	2.7	4	4	4	4
<b>1.3 Grante për mbështetje buxhetore</b>	<b>11.6</b>	<b>10.6</b>	<b>13.0</b>	<b>10.6</b>	<b>10.6</b>
<b>1.4 Grante e përcaktuara të donatorëve</b>	<b>8.0</b>	<b>12.0</b>	<b>12.0</b>	<b>12.0</b>	<b>12.0</b>
<b>2. GJITHSEJ SHPENZIMET BUXHETORE</b>	<b>2,091.3</b>	<b>2,357</b>	<b>2,386</b>	<b>2,478</b>	<b>2,600</b>
<b>2.1 Shpenzimet Rrjedhëse</b>	<b>1,537.1</b>	<b>1,653</b>	<b>1,767</b>	<b>1,694</b>	<b>1,753</b>
<i>Paga dhe mëdije</i>	615.9	619	634	691	730
<i>Mallra dhe Shërbime</i>	293.9	357	308	367	384
<i>Subvenciona dhe transfere</i>	627.3	633	781	630	634
<i>Rezerva rrjedhëse</i>	0.0	44	44	5	5
<b>2.2 Shpenzimet Kapitale</b>	<b>530.8</b>	<b>672</b>	<b>687</b>	<b>746</b>	<b>804</b>
<i>Financimi nga: Buxheti i rregullt</i>	384.5	510	510	562	612
<i>Klauzola e investimeve</i>	14.4	77	77	184	191
<i>Fondet e likuidimit (AKP)</i>	131.9	85	0	0	0
<b>2.3 Interesi për Borxhin Publik</b>	<b>23.6</b>	<b>32</b>	<b>32</b>	<b>39</b>	<b>43</b>
<b>2.4 Grantet e Përcaktuara të Donatorëve</b>	<b>5.0</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>12</b>
<b>3. Bilanci buxhetor (1-2)</b>	<b>-202.7</b>	<b>-337</b>	<b>-564</b>	<b>-350</b>	<b>-352</b>
<b>4. Shpenzimet e përjashtuara nga kufiri i rr. fiskale:</b>	<b>183.4</b>	<b>190</b>	<b>125</b>	<b>200</b>	<b>197</b>
<i>Shpenzimet nga pranimet e dedikuara për AKP/2</i>	6.5	6	6	6	6
<i>Shpenzimet nga të hyrat komunale të bartura</i>	30.7	22	42	10	0
<i>Shpenzimet kapitale nga klauzola investive dhe likuidimi</i>	146.3	162	77	184	191
<b>5. BILANCI BUXHETOR, sipas kufirit të rr. fiskale (3+4)</b>	<b>-19.3</b>	<b>-147</b>	<b>-439</b>	<b>-150</b>	<b>-155</b>
<b>A. Nevoja për financim</b>	<b>-202.7</b>	<b>-337</b>	<b>-564</b>	<b>-350</b>	<b>-352</b>
<b>B. Financimi i Jashtëm</b>	<b>-4.1</b>	<b>94</b>	<b>198</b>	<b>135</b>	<b>165</b>
<i>Pranimet nga financimi i drejtpërdrejtë buxhetor (FMN, BB)</i>	0.0	45	147	0	0
<i>Pranimet nga projekt - kredit të rregullta buxhetore</i>	20.6	46	46	24	12
<i>Pranimita nga projekt - kredit sipas klauzoles investive</i>	14.4	77	77	184	191
<i>Pranimet për nën-huazimet e NP (bruto)</i>	12.1	35	35	25	17
<i>Dajet per pagesen e kryeqesës së borxhit të jashtëm</i>	51.2	110	110	99	54
<b>C. Financimi i Brendshëm</b>	<b>262.8</b>	<b>209</b>	<b>278</b>	<b>132</b>	<b>131</b>
<i>Pranimet nga emetimet e letrave me vlerë</i>	115.3	120	170	130	130
<i>Pranimet nga kthimi i kryeqesës së borxhit të NP (neto)</i>	10.9	11	11	11	11
<i>Pranimet nga procesi i likuidimit/privatizimit</i>	150.0	85	85	0	0
<i>Pranimiti i njehershëm nga Trusti</i>	0.0	0	0	0	0
<i>Pranimit nga të hyrat e bartura të komunave</i>	-6.3	22	42	10	0
<i>Pranimet e dedikuara për AKP</i>	5.6	6	6	6	6
<i>Dajet për nën-huazimet e NP</i>	12.7	35	35	25	17
<i>Interesi per nenhuazime</i>	2.1	2	2	2	1
<b>D. Ndryshimi në bilancin e pashpërndarë bankar (A+B+C)</b>	<b>63</b>	<b>-34</b>	<b>-89</b>	<b>-83</b>	<b>-56</b>
<b>E. Stoku i bilancit bankar të pashpërndarë</b>	<b>368</b>	<b>334</b>	<b>279</b>	<b>196</b>	<b>140</b>
<b>Memo:</b>					
<i>Të hyrat e arketuara nga ATK</i>	504	557	478	586	617
<i>Të hyrat e arketuara nga Dogana e Kosovës</i>	1,180	1,244	1,146	1,327	1,405
<i>Pranimet dhe dajet nga Grantet e Përcaktuara të Donatorëve</i>	12	12	12	12	12
<i>BPV</i>	7,111	7,464	7,039	7,548	8,016
<i>Deficiti buxhetor (definicioni i rregullës fiskale si % e BPV-së)</i>	-0.3%	-2.0%	-6.2%	-2.0%	-1.9%
<i>Bilanci bankar i shfrytëzueshem si % e BPV-së</i>	5.2%	4.5%	4.0%	2.6%	1.7%
<i>Stoku i borxhit të brendshëm</i>	792	912	962	1,092	1,222
<i>Stoku i borxhit të jashtëm</i>	410	502	604	737	901
<i>Garancionet shtetërore</i>	44	44	44	44	44
<i>Borxhi i përgjithshëm si % e BPV-së</i>	17.5%	19.5%	22.9%	24.8%	27.0%

Tabela 1.1 Financimi i Bilancit Buxhetor 2019-2022

Pershkrimi	2019	2020 Budget	2020 Rishikim	2021 Proj.	2022 Proj.
në miliona Euro					
<b>Te Hyrat Buxhetore</b>	<b>1889</b>	<b>2020</b>	<b>1822</b>	<b>2128</b>	<b>2247</b>
<b>Shpenzimet Buxhetore</b>	<b>2091</b>	<b>2367</b>	<b>2366</b>	<b>2478</b>	<b>2600</b>
<b>1. NEVOJA PËR FINANCIM</b>	<b>-203</b>	<b>-337</b>	<b>-564</b>	<b>-350</b>	<b>-352</b>
<b>2. Neto financimi nga burimet e jashtme për vitin</b>	<b>-4</b>	<b>94</b>	<b>196</b>	<b>135</b>	<b>165</b>
<b>2.1. Pranimet:</b>	<b>47</b>	<b>203</b>	<b>305</b>	<b>233</b>	<b>219</b>
Financim Direkt Buxhetor - FMN, BB	0	45	147	0	0
Nën-huazimet, bruto pranimet	12	35	35	25	17
Terheqjet nga kreditorët	4	25	25	15	7
Pranimet nga subjektet publike huazuese	8	11	11	10	10
Projekt-kreditë	35	123	123	208	203
Projekt-kreditë, klauzola e investimeve (fondi 06)	14	77	77	184	191
Projekt-kreditë, trajtim brenda deficiti (fondi 04)	21	46	46	24	12
<b>2.2. Daljet:</b>	<b>51</b>	<b>110</b>	<b>110</b>	<b>99</b>	<b>54</b>
Pagesa e kryegjesë së borxhit	51	110	110	99	54
<b>3. Neto financimi nga burimet e brendshme për vitin</b>	<b>263</b>	<b>209</b>	<b>279</b>	<b>132</b>	<b>131</b>
<b>3.1. Pranimet:</b>	<b>526</b>	<b>446</b>	<b>635</b>	<b>377</b>	<b>329</b>
Emetimet e reja të letrave me vlerë	115	120	170	130	130
Pranimet nga emetimet e letrave me vlerë për qëllime rifinancimi	245	200	200	220	182
Kredidhënia për NP (kryegjësja)	11	11	31	11	11
Financimi i njehereshem nga likuidimi/privatizimi dhe të tjera	150	85	85	0	0
Pranimet e dedikuara për AKP/1	6	6	6	6	6
Pranimet nga stoku i fondeve me qëllime specifike (kur FS2 dhe FS3 zvogelohen)	0	22	42	10	0
<b>3.2. Daljet:</b>	<b>264</b>	<b>235</b>	<b>255</b>	<b>245</b>	<b>199</b>
Kredidhënia për NP	0	0	20	0	0
Nën-huazimet, bruto daljet	13	35	35	25	17
Daljet për shërbim të borxhit tek kreditorët	9	11	11	10	10
Daljet për nën-huazim tek subjektet publike huazuese	4	25	25	15	7
Daljet nga emetimet e letrave me vlerë për qëllime rifinancimi	245	200	200	220	182
Dalje për rritjen e fondeve me qëllime specifike (FS2 dhe FS3 rriten)	6	0	0	0	0
<b>4. NDRYSHIMI NË BILANCIN E PASHPËRNDARË BANKAR (1+2+3)</b>	<b>63</b>	<b>-34</b>	<b>-89</b>	<b>-83</b>	<b>-56</b>
<b>5. NETO BILANCI BANKAR FUNDVIT</b>	<b>368</b>	<b>334</b>	<b>279</b>	<b>196</b>	<b>140</b>
<i>Nga të cilat: Fondi për Likuiditet Emergjent</i>	46	46	46	46	46
<b>6. FONDET ME QËLLIME SPECIFIKE, tjetërdja e stoqeve/2</b>	<b>90</b>	<b>67</b>	<b>47</b>	<b>37</b>	<b>37</b>
FS1: Grantet e përcaktuara nga donatorët	9	8	8	8	8
FS2Q: Të hyrat vetanake të bartura - Niveli Qendror	6	3	3	3	3
FS2K: Të hyrat vetanake të bartura - Niveli Lokal	49	32	12	7	7
FS3: Fondi zhvillimor në mirëbesim	8	6	6	2	2
FS4: Pranimet e dedikuara për bartje	1	1	1	1	1
<b>7. BRUTO BILANCI BANKAR NE FUNDVIT</b>	<b>458</b>	<b>401</b>	<b>326</b>	<b>233</b>	<b>177</b>
<b>8. NDRYSHIMI NË BRUTO BILANCIN BANKAR</b>	<b>70</b>	<b>-57</b>	<b>-132</b>	<b>-93</b>	<b>-56</b>
Memo:					
Stoku i borxhit të brendshëm	792	912	962	1092	1222
Stoku i borxhit të jashtëm	410	502	604	737	901
Garancionet shtetërore	44	44	44	44	44
Shpenzimet e interesit si % e BPV-së	0.4%	0.4%	0.5%	0.5%	0.5%





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/23  
Datë: 08.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Nenit 4. paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për negocimin e paketës së marrëveshjeve ndërkombëtare me qëllim të sigurimit të financimit publik për përballimin e situatës së krijuar nga virusi CORONA (COVID -19), me Institucione Ndërkombëtare Financiare si në vijim:
  - 1.1. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe anëtarët e tjerë të Bankës Botërore;
  - 1.2. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;
  - 1.3. Fondi Monetar Ndërkombëtar;
  - 1.4. Banka Islamike për Zhvillim;
  - 1.5. Agjensionet zyrtare për përkrahjen (financimin) e eksportimit; dhe
  - 1.6. Institucionet zyrtare financiare bilaterale të vendeve të jashtme ose të Bashkimit Evropian;
  - 1.7. Banka Evropiane e Investimeve.
2. Kufiri i përgjithshëm i autorizimit të dhënë sipas pikës 1 të këtij vendimi për marrëveshjet financiare të huasë është dyqind e pesëdhjetë milion (250,000,000.00 €) ose ekuivalent, me afat të maturimit deri në pesëmbëdhjetë (15) vite dhe me normë të interesi jo më të lartë se tre (3 %) për qind.
3. Kufizimi sipas pikës 2 të këtij vendimi nuk vlen për marrëveshjet financiare të grantit.
4. Përgjatë negocimit të këtyre marrëveshjeve, Ministria Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/23  
Datë: 08.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Financiare për IPA 2019, pjesa e dytë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Obligohet Ministria e Integrimit Evropian të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/23

Datë: 08.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Financiare për IPA 2020, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/23  
Datë: 08.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma nënshkrimin e Marrëveshjes financiare trepalëshe mes Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut për vitin 2019, për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/23

Datë: 08.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për nënshkrimin e Marrëveshjes financiare trepalëshe mes Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Malit të Zi për vitin 2019, për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II mes Kosovës dhe Malit të Zi.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/23  
Datë: 08.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për nënshkrimin e Marrëveshjes financiare trepalëshe mes Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Shqipërisë për vitin 2019, për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II mes Kosovës dhe Shqipërisë.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/23

Datë: 08.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-221; Ligjin 04/L-116, Ligjin 04/L-194, dhe Ligjin 05/L-063, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të dhunuar gjatë luftës Çlirimtare të Kosovës, për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 161,650 euro për përmbushjen e obligimeve ligjore të aktiviteteve për zbatimin e të cilave kërkohet mbështetje buxhetore.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nënprogrami Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve Rezervat.
3. Mjetet transferohen në Ministrinë e Financave dhe Transfereve në nënprogramin Zbatim i Ligjit Nr. 04/L-054 për V.Dh.S me kod 02200 në kategoritë e shpenzimeve "Paga dhe Shtesa" shuma prej 42,600 euro dhe "Mallra dhe Shërbime" shuma prej 119,050 euro.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë